REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ARTEVE**
**SENATI AKADEMIK**

## DEKLARATË E SENATIT AKADEMIK TË UNIVERSITETIT TË ARTEVE

Senati Akademik i Universitetit të Arteve (UART), në mbledhjen e datës 13.12.2018 si dhe në zbatim të kompetencave të tij ligjore dhe në mbështetje të protestës së studentëve, në mbledhjen e tij vendosi unanimisht që të shprehet në këtë deklaratë:

1. Të mbështesë kërkesat e formuluara nga studentët.
2. Të mbështesë si të nevojshme përgjysmimin e tarifave të shkollimit dhe t'i kërkojë Bordit të Administrimit përllogaritjen e efektit financiar për UART.
3. Senati Akademik i UART merr përsipër me përgjegjësi përfshirjen e të gjitha mekanizmave financiarë, materialë dhe proceduralë për të garantuar transparencë maksimale dhe realizimin e tyre brenda vitit akademik 2018-2019, të të gjitha hapave të duhura drejt një arsimimi artistik cilësor, etikës në krijimtari e kërkim shkencor, por dhe përfshirjes direkte të studentëve,.
4. Senati Akademik i UART mer përsipër përfshirjen në statut dhe rregulloret e brendshme të institucionit, kodifikimin e rregullave të qarta që do të garantojnë pjesëmarrjen e nevojshme të studentëve në veprimtaritë akademike dhe financiare.
5. Senati Akademik i UART mer përsipër të ngrejë një grup të përbashkët pune, pedagogë dhe studentë, për shqyrtimin e të gjitha problematikave të ngritura dhe çështjeve të tjera që lidhen me përmirësimin e veprimtarisë së UART.
6. Kjo deklaratë, të publikohet në faqen zyrtare të UART.

**<u>SENATI AKADEMIK I UNIVERSITETIT TË ARTEVE</u>**